



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 7, paragrafi 6 i nenit 21 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike (LFSP), me datën 10.07.2024, merr këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik të regjistruar PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS

- I. Subjektit politik PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 7, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi, gjobat ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga Përmbaruesi Privat.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

Arsyetim

Subjekti politik PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS, është subjekt politik i regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, nga data 21.08.2000.

Pas dorëzimit të raportit vjetor financiar nga subjekti politik, Zyra ka vërejtur se subjekti Raporti vjetor financiar i subjektit politik PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS, që ka qenë subjekt i auditimit ka përfshirë periudhën raportuese 01.01.2023 – 31.12.2023. Sipas gjetjes së auditorit ligjor, subjekti politik nuk ka ofruar asnjë dokumentacion mbështetës për të hyrat dhe shpenzimet e prezantuara për periudhën raportuese. Auditori ligjor, përmes komunikimit me shkrim (e-mailit) ka kërkuar nga personat e autorizuar të subjektit politik, dokumentet mbështetëse me qëllim të auditimit të shpenzimeve të bëra nga kjo parti politike. Kërkesat përmes komunikimit elektronik, janë dërguar në datat: 22.04.2024, 29.05.2024 dhe

10.06.2024, me ç 'rast, subjekti politik nuk është përgjigjur në asnjërën nga kërkesat e dërguara nga auditori ligjor për dokumente mbështetëse të shpenzimeve të bëra gjatë periudhës raportuese, që ishte subjekt auditimi.

Subjekti politik PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimi të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë. Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, gjoba e shqiptuar ndaj subjektit politik do të ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga Përmbaruesi Privat.

Nga sa u tha më lartë, Zyra vendosi për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 10.07.2024

Drejtori i Zyrës


Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS.

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.